

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1000 Prot.

Tiranë, më 27.09 2016

VENDIM Nr. 94, datë 14.09.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 11 të datës 14.09.2016, pasi shqyrtoi *Konceptin e kryerjes së gërmimit arkeologjik të shpëtimit* të varrit të identifikuar në profilin e rrugës për te Porti i Jahteve (Porto Albania), tek "Kalaja e Turrës", gjatë verifikimit të punimeve të *projektit "Porti i Jahteve, Kalaja e Turrës", Synej - Kavajë, subjekti "Finsec Port" sh.a.*, paraqitur nga subjekti i licencuar në arkeologji znj. Lida Miraj,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Konceptin e kryerjes së gërmimit arkeologjik të shpëtimit* të varrit të identifikuar në profilin e rrugës për te Porti i Jahteve (Porto Albania), tek "Kalaja e Turrës", gjatë verifikimit të punimeve të *projektit "Porti i Jahteve, Kalaja e Turrës", Synej - Kavajë, subjekti "Finsec Port" sh.a.*, paraqitur nga subjekti i licencuar në arkeologji znj. Lida Miraj.
2. Investitori *"Finsec Port" sh.a* për kryerjen e gërmimit arkeologjik sipas konceptit të paraqitur, duhet të lidhë më parë kontratë tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë atë. Raporti i tyre do të paraqitet në KKA e radhës.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të kontratës tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETARI I KKA
RUDINA ZOTO